



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

NR. 51, Datë 19.3.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “ MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR
NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE PRANË PROKURORISË SË POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”**

Në mbështetje të neneve 148/dh dhe 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 47, 48 dhe 163 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 189 të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe neneve 2, 7, 12 dhe 57 të ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

